



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 5387/2026  
Data: 16.06.2026

**PROCESVERBAL I KOMITETIT PER KOMUNITET**

Nga mbledhja e pestë -V-për vitin 2026 i Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 26.05.2026 me fillim pune në ora 14:30 në sallën e takimeve. Prezent ishte **Shefket Lusnjani** (Kryetarë i Këshillit të Fshatit Gorancë), **Bashkim Sopa** (Zyrtar për Transparencë).

**RENDI I PUNËS**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Takim me përfaqësuesit e dy Këshillave të Fshatrave.
3. Takim me Përfaqësuesin e Bizneseve në Han të Elezit.
4. Eventuale.

**U MIRATUA RENDI I PUNËS**

**1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin; nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR**

## 2. Takim me përfaqësuesit e dy Këshillave të Fshatrave

**Kryesuesi** thekson: komuniteti për komunitete merret me problemet të cilat i kanë fshatrat dhe është fatmirësi, në këtë rast, që Goranca ka përfaqësues në Kuvend Komunal, por mundesh me i parashtruar edhe këtu, që na me i paraqitur në Kuvend Komunal. Por ne do të diskutojmë që ti, si këshilltar dhe si asamblist, për me i arritur qëllimet për fshatin Gorancë. Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Shefket Lusnjani** thekson: shqetësimet e mia i paraqes në Kuvend. Projektet e mia gati se janë të realizuara, por mund të them se janë realizuar, ndërsa projektet të cilat janë të porealizuara kanë me vazhduar në këtë vit dhe vitin e ardhshëm. Projekti i parkut te pishat do të vazhdojë. Po ashtu, në bisedën të cilën e pata me kryetarin për rrugën Gorancë-Krivenik, edhe ajo do të vazhdojë. Një shqetësim e kam ngritë te Drejtoria e Urbanizmit për rrugën nga fshati Rezhancë deri te varrezat e fshatit Rezhancë, por ka premtuar që do të kryhet. Si kryetar i Shoqatës së Pensionistëve do ta parashtroj kërkesën për dërgimin e pensionistëve në bajë, pasi që katër vjet rresht komuna i ka dërguar pensionistët në bajë.

**Kryesuesi** thekson: çdo çështje që është në interes të qytetarëve, në Kuvend kemi me shqyrtuar. Shtresa që ka më shumë nevojë për bajë janë pensionistët, sepse deri tash ka qenë mirë dhe do të vazhdojë, por ti, si kryetar i Shoqatës së Pensionistëve dhe si asamblist, mundesh me adresuar në Kuvend Komunal dhe besoj që nga ana ime dhe anëtarëve të cilët jemi, e përkrahim.

**Sead Vila** thekson: isha duke shkuar për fshatin Glloboqicë dhe kalova ka kjo pjesa e rrugës së Gorancës, dhe e pashë që diçka ka ndryshuar për mirë, por a ka ende diçka për me u rregulluar te ajo rrugë? Para dy vjetëve kam qenë te parku te pishat dhe më ka pëlqyer si zonë që komuniteti i asaj ane, por edhe Hani i Elezit me e shfrytëzuar, por a i plotëson kushtet elementare?

**Shefket Lusnjani** thekson: sa i përket rrugës, jemi munduar shumë që me u kryer dhe rrugën do ta mirëmbajnë dy vjet. Sipas njoftimit të tyre që më kanë njoftuar, kanë potencuar që kanë me vendosur një mur poshtë në rekë, në mënyrë që toka mos me lëvizur. Te parku te pishat besoj që në të ardhmen edhe uji do të sigurohet, qoftë përmes shpimit të pusit apo ndonjë alternativë tjetër. Për mirëmbajtje, janë duke e mirëmbajtur mirë; janë edhe kontejnerët.

**Kryesuesi** thekson: si rekomandim i përgjithshëm mund të themi që këshillat e fshatrave, të cilët nuk janë të përfaqësuar në Kuvendin Komunal, për çdo ankesë dhe kërkesë mund të adresohen tek ne dhe ne mund t'i përcjellim në Kuvend të Komunës. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk keni, kalojmë në pikën e radhës, të paraparë sipas agjendës.

## 3. Takim me Përfaqësuesin e Bizneseve në Han të Elezit

**Kryesuesi** thekson: komuniteti i bizneseve në Han të Elezit nuk është duke funksionuar, por do ta diskutoj me kryetarin e komunës për me e aktivizuar në të ardhmen. Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin. Nëse nuk keni, kalojmë në pikën e radhës, të paraparë sipas agjendës.


## 4. Eventuale

**Kryesuesi** thekson: a keni ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk keni shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në 14:25.

Procesmbajtësi

Ayni Bushi



Kryesuesi i Komitetit  
Basri Derrjani

